

BEQIR META

**BALLAFAQIMI SHQIPTARO-GREK PËR HIMARËN
1920-1924**

Himara është një krahinë shqiptare me tipare të qarta të përkatësisë kombëtare shqiptare. Sipas studimeve më serioze dhe në bazë të dëshmive të shumta dhe nga të gjitha fushat provohet qartësisht se pakica greqishtfolëse në Himarë nuk është e etnisë greke. Ajo është thjesht një pakicë gjuhësore, madje dygjuhësore e kombësisë shqiptare. Faktet historike, tradita vendase, gjuha dhe trashëgimia gojore, toponimike dhe onomastike dëshmojnë se himarjotët janë shqiptarë. Himarjotët kanë dhënë një kontribut të çmuar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, gjë që është evidentuar qartë nga historiografia shqiptare.

Pas mbarimit të Luftës I Botërore lëvizja atdhetare shqiptare në Himarë u rigjallërua. Një vend të veçantë luajti Spiro Gogo Koleka, i cili ndihmoi për mbledhjen e Kongresit të Lushnjës dhe zbatimin e vendimeve të tij. Ai bashkë me patriotë të tjerë ishte nënshkruesi i mjaft dokumenteve dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes, në të cilat kundërshtojnë çdo përpjekje për aneksimin e Vlorës dhe Himarës¹. Në maj të vitit 1920 Spiro G. Koleka u caktua anëtar i qeverisë kombëtare. Ai më vonë u bë njëri nga organizatorët e Luftës së Vlorës kundër italianëve, në të cilën morën pjesë edhe himarjotët të tjerë.

Në këtë kohë klika filogreke që drejtohej nga Spiro Milo, duke përfituar nga mungesa e kontrollit qeveritar në Himarë, po bënte kontrabandën më të madhe në këto vise². Ajo shfrytëzoi vakuumin e krijuar nga zhvillimi i luftimeve midis forcave shqiptare dhe ushtrisë italiane. Kur kjo u largua nga Himara, për njëfarë kohe ky rajon mbeti

¹ Muin Çami, *Himara në vitet 1912-1914*, në botimin e Akademisë së Shkencave me titull "Himara në shekuj", Tiranë 2006, f. 205.

² Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSh), Fondi: MPB, viti 1920, dos.234, fl.32. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, Gjirokastrë, 7 qershor 1920.

jashtë kontrollit sepse forcat kombëtare shqiptare nuk e ndjenin veten aq të fortë përballë italianëve në Vlorë, sa që të hiqnin disa reparte shqiptare nga fronti dhe t'i dërgonin në Himarë. Në këto rrethana, grupi i kryesuar nga Niko Milo shpalli autonominë e Himarës në 7 fshatra³. Qazim Kokoshi informonte Zogun se "ne, duke pasur një armik përpara, nuk mund të ktheheshim në Himarë e të merreshim me këtë çështje"⁴.

E shqetësuar nga lëvizja në Himarë, krahina e Kurveleshit bëri një mbledhje të përgjithshme dhe e shpalli Kurveleshin nënprefekturë nëpërmjet Riza Runës. Kurveleshi mori nën administrim edhe Borshin, Çorrajn, Fterrën, Kuçin, Bolenën dhe Kallaratin, të cilat më parë i përkisnin Himarës, gjë që deri në këtë kohë kishte siguruar shumicën e shqiptarëve që flisnin vetëm shqip në nënprefekturën e Himarës, ndaj një pakice që fliste të dyja gjuhët, shqip dhe greqisht. Kjo mbledhje, në këtë moment delikat, u konsiderua e rrezikshme. Q. Kokoshi i sugjeroi A. Zogut të mos miratohej kërkesa e shpallur në mbledhjen e Kurveleshit⁵.

Lëvizja e Spiro Milos shkaktoi një zemërim dhe tension të madh në popullsinë shqiptare. Në Vlorë filluan përgatitjet për ta asgjësuar këtë lëvizje me armë⁶. Qeveria u gjend në një pozitë të vështirë. Ajo dha udhëzime dhe mori masa energjike për ndalimin e çdo veprimi kundër lëvizjes separatiste të Spiro Milos. Ministria e Punëve të Brendshme u dha urdhër prefekturave të Vlorës dhe Gjirokastrës që "të merreshin masat më të shpejta e më të rrepta dhe në e dashtë nevoja edhe me armë të ndalohet çdo lëvizje që mund të bëhet mbi Himarë"⁷.

Situata e krijuar nxiti administratën shqiptare që të merrte masa për ta zgjidhur çështjen paqësisht. Oficeri shqiptar nga Himara, Koço Muka i sugjeroi qeverisë që të dërgonte në Himarë disa oficerë himarjotë që gëzonin besimin e popullit të Himarës, i cili, nënvizonte Muka, nuk ishte kundër qeverisë shqiptare⁸.

³ *Po aty*, dos.16, fl.4-5. Letër e prefektit të Vlorës, Qazim Kokoshi, dërguar ministrit të Brendshëm, A. Zogut, Fier, 20 korrik 1920.

⁴ *Po aty*.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Po aty*, fl.11-12. Prefekti i Gjirokastrës, Kol Tromara-MPB, 7 tetor 1920.

⁷ *Po aty*. MPB-Prefekturës së Gjirokastrës dhe Prefekturës së Vlorës, 10 tetor 1920.

⁸ *Po aty*, fl.26. Letër e Komandantit të Kompanisë së Xhandarmërisë së Tepelenës, Koço Muka, dërguar N. Delvinës.

Edhe Prefektura e Vlorës kishte një plan paqësor për zgjidhjen e problemit, i cili bazohej në faktin se populli i Himarës, në përgjithësi, ishte në favor të bashkimit me atdheun dhe me qeverinë shqiptare. Sipas këtij plani nga "paria" shqiptare në fshatrat e Himarës do të rekrutoheshin si xhandarë një sasi njerëzish, të cilët do të vepronin në fshatrat e tyre. Në këtë mënyrë do të përgatitej me dëshirën e pjesës atdhetare të popullsisë, bashkimi i Himarës me qeverinë shqiptare. Përveç kësaj do të emëroheshin edhe oficerë rezervë që do të qëndronin në fshatrat e tyre për të bërë propagandën e bashkimit⁹.

Mirëpo qeveria shqiptare ishte edhe nën presionin e fortë grek. Guvernatori i Përgjithshëm i Epirit i kërkoi prefekturës së Gjirokastrës që "shtetësia e sotme e Himarës do të mbetet e nderuar ashtu siç ndodhet sot, dhe çdo përpjekje që do të bëhet për të prishur këtë qetësi të sotme, s'ka për të dhënë asnjë fryt. Çdo gjë që do të bëhet kundër Himarës do t'i bënte një përshtypje të keqe qeverisë greke dhe më në fund do të shkaktonte ngjarje të papëlqyera"¹⁰.

Qeveria shqiptare u shqetësua nga kjo ndërhyrje. Ministria e Jashtme e konsideronte atë "një grackë politike për të marrë një shkresë zyrtare, në të cilën të pranohej ekzistenca e autonomisë së Himarës"¹¹. Guvernatori i Janinës kishte përmendur tre herë vetëqeverimin e Himarës dhe kishte nënvizuar se ky status kishte fituar miratimin e qeverisë së Tiranës. MPJ e Shqipërisë kritikoi veprimin e N. Delvinës, i cili, pa u konsultuar me qeverinë e vet, i ishte përgjigjur guvernatorit të Janinës pa e kundërshtuar fjalën vetëqeverim, të pranuar gjoja prej qeverisë së Tiranës. Kështu MPJ mendonte se ai i kishte dhënë Greqisë një akt zyrtar që gjoja pranonte vetëqeverimin e Himarës. Nga ana tjetër, për të përforcuar këtë akt, Niko Milo, në një letër që i shkruante prefektit të Gjirokastrës, përdorte përsëri frazën "në kufirin e Himarës së vetëqeverisur që e ka njohur qeveria respektive e Tiranës"¹². MPJ këshillonte që këto nëpunës të mos futeshin në kontakte direkte për probleme të tilla që i takonin MPJ dhe kërkonte që Prefektura e

⁹ *Po aty*. Letër e N. Delvinës-MPB, Gjirokastrë, 29 tetor 1920.

¹⁰ *Po aty*, dos.17, fl.1-2. Notë e Guvernatorit të Përgjithshëm të Epirit-Prefekturës së Gjirokastrës, Janinë, 11 shtator 1920.

¹¹ *Po aty*, dos.16, fl.17-18. Letër e MPJ-MPB, 2 nëntor 1920.

¹² *Po aty*.

Gjirokastrës t'i përgjigjej Niko Milos, se qeveria e Tiranës nuk kishte marrë asnjë vendim për të njohur vetëqeverimin e Himarës¹³.

Në këtë situatë, Këshilli i Ministrave vendosi që, pasi momenti nuk ishte i përshtatshëm për të hyrë ushtarakisht në Himarë, të merreshin masat e nevojshme prej prefekturës dhe "të bëheshin sakrifica morale e materiale në Himarë që të ngrihet populli i vendit, e kështu Himara të merret në sundim prej fuqisë sonë"¹⁴.

Duke vijuar me politikën e afrimit me himarjotët, me propozim të prefekturës së Vlorës, MPB ndaloi rekrutimin ushtarak në Himarë¹⁵.

Në janar të vitit 1921 në Himarë mbretëronte anarkia. Familjes Milo, që ishte vegla kryesore e politikës greke, nuk i bindej më njeri. Ata e kishin humbur gjithë influencën në popull¹⁶.

Ish kryetari i Parlamentit Shqiptar Kacimbra, nga Gjirokastra, bëri një marrëveshje me himarjotët, të cilët pohuan se shumica e tyre dëshironte të merrte pjesë në zgjedhje¹⁷. Mirëpo, meqenëse situata në Himarë ishte jo e qetë, ai propozoi që për zgjedhësit e dytë himarjotët të votonin në fshatrat Piqeras ose Shën Vasil. Kacimbra propozonte që, me anë të nacionalistëve himarjotë, të bëhej propagandë që të tërhiqej në votime edhe pjesa kundërshtare e popullit¹⁸. Më pas MPB udhëzoi që votimet për deputetin e Himarës të bëheshin në Gjirokastër dhe porositi që në to të merrnin pjesë sa më shumë himarjotë. Por pjesëmarrja e himarjotëve në votime ishte shumë e pakët. Nga 8 000 vetë votuan vetëm 50¹⁹. Për këtë arsye MPB mendoi t'i shpallte zgjedhjet e Himarës të paligjshme. Ajo porositi që zgjedhësit e dytë të Himarës të votonin vetëm për deputetin e Himarës dhe jo për gjithë deputetët e qarkut, siç e përcaktonte ligji. Por ky mendim u kundërshtua nga Prefektura e Gjirokastrës. Zëvendës prefekti Hasan Dosti e quante të dëmshëm anulimin e zgjedhjeve. Aq më tepër kur zgjedhës të dytë, me vota fare të pakta, ishin shpallur edhe në shumë fshatra grekofone të Libohovës e të Delvinës. Përfundimi i zgjedhësve të dytë të Himarës nga votimi për

¹³ *Po aty*.

¹⁴ *Po aty*, fl.24. Vendim i Këshillit të Ministrave, dt.1 dhjetor 1920.

¹⁵ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.48, fl.1-3. Prefektura e Vlorës-MPB, 10 janar 1921.

¹⁶ *Po aty*, dos.46, fl.1-2. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 24 janar 1921.

¹⁷ *Po aty*, dos.23, fl.8. MPB-prefekturave Vlorë e Gjirokastër, 24 janar 1921.

¹⁸ *Po aty*, fl.9. Dh. Kacimbra dhe Kiço Koçi-Kryeministrisë, 26 janar 1921.

¹⁹ *Po aty*, fl.30.

deputetët e provincës së Gjirokastrës do të bënte përshtypje të keqe në opinionin e nacionalistëve të Himarës, një pjesë e të cilëve, prej këtij shkakut, ishin dëbuar nga Himara dhe po vuanin në Delvinë e Sarandë. Nga ana tjetër, në qoftë se këta do të votonin vetëm për deputetin e Himarës, ky nuk do të kishte një pozitë të njëjtë me deputetët e tjerë të parlamentit shqiptar dhe kjo nuk do t'i shërbente qëllimit të bashkimit të Himarës me administratën shqiptare²⁰. Pas kësaj MPB e rishqyrtoi qëndrimin e saj dhe udhëzoi që zgjedhësit e dytë të Himarës të merrnin pjesë, bashkë me zgjedhësit e qarqeve të tjera, në zgjedhjen e deputetëve²¹.

Por edhe qeveria greke po kërkonte të ishte një hap më përpara se qeveria shqiptare në çështjen e Himarës. Më 27 prill 1921 ajo emëroi si guvernator të Himarës, Stefan Zhupën nga Dhërmiu, i cili ishte kapiten i ushtrisë greke. Emërimi u prit me entuziazëm nga grekomanët në Himarë e në Korfuz²². Situata ishte e rrezikshme. Në Korfuz u përhap një lajm se Vehip Runa i kishte kërcënuar himarjotët që, në qoftë se nuk do të bashkoheshin me shtetin shqiptar, Himara do të digjej tërësisht.

Nga Himara u dërgua menjëherë një komision në Korfuz, ku filluan demonstrimet antishqiptare dhe regjistrimi i vullnetarëve. Në Athinë u mbledh Këshilli i Ministrave për të diskutuar çështjen e Himarës, ndërsa u rrit presioni dhe shtypja kundër elementit shqiptar të Çamërisë, në të cilën po zhvillohej fushata për mbledhjen e armëve²³. Një ditë më vonë, një vapor grek zbarkoi në Himarë 50 ushtarë grekë, armë dhe municione²⁴.

Paria e Himarës i dërgoi një letër edhe parisë së Dukatit, me të cilën njoftonin se Vehip Runa nga Nivica, në emër të popullit shqiptar dhe të Komitetit Shqiptar, kishte kërkuar të hiqnin dorë nga vetëqeverimi i Himarës. Ai e kishte bërë të qartë se në rast të kundërt populli shqiptar dhe Komiteti Shqiptar do ta shkatërronte vetëqeverimin me armë. Pleqësia e Dukatit ishte përgjigjur se ata i bindeshin urdhrave të qeverisë

²⁰ *Po aty*, fl.102. Zëvendësprefekti i Gjirokastrës, Hasan Dosti-MPB, 13 mars 1921.

²¹ *Po aty*, fl.111. Udhëzime të MPB, 15 mars 1921.

²² *Po aty*, dos.46, fl.18. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 27 prill 1921.

²³ *Po aty*. Zëvendësprefekti i Gjirokastrës, Aqif Përmeti-MPB, 10 maj 1921.

²⁴ *Po aty*, fl.33. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 11 maj 1921.

dhe i ftuan himarjotët që të bashkoheshin me ta meqë ishin vëllezër²⁵. Pas 4-5 ditësh ushtarët grekë që kishin zbarkuar në Himarë u larguan për në Korfuz²⁶.

Ndërkohë shtypi filloi të kritikonte qeverinë për qëndrimin e saj apatik ndaj Himarës. Gazeta "Mbrojtja Kombëtare" shkruante se Himara kishte 10 000 banorë, "të gjithë shqiptarë, me të gjitha cilësitë janë bijtë e vërtetë të pellazgëve dhe pa asnjë ndryshim karakterizojnë pamjen e një shqiptari të vjetër, trim, besnik, luftëtar e bujar atdhetar"²⁷, por që ishte lënë mënjanë nga qeveria shqiptare.

Që pas luftës me italianët, qeveria, megjithëse nuk kishte më të voglin ndalim e pengim, e la këtë krahinë shqiptare të bëhet vegël greke. Qeveria i trembej Greqisë, se ajo mund të kapërcente kufirin e 1913-ës, por më kot, sepse Greqia po të vendoste ta bënte këtë nuk do të përgjonte marrjen e Himarës prej qeverisë shqiptare²⁸. Ajo e quante këtë qëndrim të qeverisë shqiptare rezultat të Protokollit të Kapshticës, i cili konsiderohej i gabuar. Gazeta sugjeronte që Himara duhej bashkuar me Shqipërinë tani kur Greqia ndodhej në luftë me Turqinë sepse, pas kësaj lufte, ajo do të shtonte presionin për të fuqizuar influencën greke në Himarë. "Greqia, sado që ndodhet në luftë si luan i plagosur, s'po heq dorë nga Himara, se ja çmon vleftën dhe famën që do t'i japë nesër, kur ajo të njësohet. Politikisht, strategjikisht dhe kombëtarisht, Himara zë radhën e parë për Shqipërinë. Gjithë këto nuk i merr në sy qeveria. Por atëherë patriotët bregdetas me vëllezërit e tyre të krahinave të tjera do të mendojnë vetë për bashkimin e Himarës, qoftë me mënyra të urta, qoftë me të hequr veshin. Si mundet të lemë 7 katunde në rebelizëm? Si mundet ta bëjmë Shqipërinë koloni të armiqve. Qeveria jonë të mos vejë me ishallahe, por me të shpejtë të veprojë me çdo mënyrë, sepse himarjotët grekomanë, që zotërojnë sot Himarën shqiptare, janë më të rrezikshëm se esadistët vite më parë, sepse të fundit e kishin babën larg, ndërsa këta e shohin me sy Greqinë dhe punojnë me sistem duke pasur shumë Esatër dhe më të zotët se ai, të cilët marrin urdhra nga Janina dhe Korfuzi. Sot erdhi koha të bashkohet Himara, të prishet dhe Protokollit i Kapshticës e të mos i shkojmë ndër mend blufet e grekëve"²⁹.

²⁵ *Po aty*, dos.45, fl.91-92. Prefekti i Vlorës, Qazim Koculi-MPB, 12 maj 1921.

²⁶ *Po aty*, fl.95. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 14 maj 1921.

²⁷ *Himara*, "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, 10 shkurt 1921.

²⁸ H. Xhelo, *Greqia e Vogël brenda në Shqipëri*, "Mbrojtja Kombëtare", 12 maj 1921.

²⁹ *Po aty*.

Në popullsinë e zonave përreth vijonte të ndjehej era e një lëvizjeje për t'u futur në Himarë forcërisht³⁰. Kjo situatë alarmoi qeverinë, e cila dha porosi të prera që të frenohej çdo lloj aksioni. Ministria e Brendshme u tërhoqte vëmendjen prefekturave të Vlorës e Gjirokastrës se në qarqet zyrtare e popullore të atjeshme ishte ngjallur një dëshirë për të okupuar Himarën. Ajo pohonte se kjo lëvizje kishte dy shkaqe: "nga një patriotizëm krejt i gabuar dhe nga një propagandë e huaj që ka interes ta fusë Shqipërinë në ndonjë kurth që të mos mundë të dalë e gjallë. Qeveria e di fare mirë rëndësinë e Himarës. Por okupimi i saj nga ana jonë do të thotë shpallje lufte Greqisë. Qeveria është plotësisht e vendosur që çdo njeri, me qëllim të mirë ose me qëllim të lig, që kërkon të ngjallë një çështje të këtillë të rrezikshme, do ta dënojë deri në varje"³¹. Ministria e Brendshme urdhëroi të këshilloheshin të gjithë zyrtarët civilë e ushtarakë që të hiqnin dorë nga të tilla provokacione dhe kushdo që bënte propagandë të tillë të arrestohej dhe t'i dorëzohej Gjyqit Politik në Tiranë³². Por nga ana tjetër MPB, për të ushtruar presion ndaj qarqeve grekomane të Himarës, pranoi që të largoheshin nga Delvina tufat e bagëtive të Himarës pasi të merrej më parë taksi i xhelepit³³.

Ministria e Brendshme projektoi bashkimin e Himarës me mjete paqësore dhe duke fituar mbështetjen e gjithë banorëve të saj. Ajo udhëzoi që forcat shqiptare të hynin në Himarë, me në krye komisionin përfaqësues të himarjotëve që drejtohej nga Spiro Koleka. Ajo jepte porosi të prera që të mos ndodhte asnjë vrasje dhe që okupacioni të ishte paqësor në sytë e Evropës dhe të bëhej me pëlqimin e shumicës së popullsisë së Himarës³⁴. Për ta bërë më të lehtë punën, Prefektura e Vlorës i propozoi qeverisë që t'u jepej një shpërblim disa krerëve grekomanë. Familjes Milo t'i jepeshin 500 napolona dhe 500 napolona të tjerë disa të tjerëve³⁵.

Qeveria pajisi me një letër përfaqësimi delegatin e saj Fuqiplotë për zgjidhjen e çështjes së Himarës. Ai do të përfaqësonte qeverinë dhe do ta zgjidhte problemin në bazë të këtyre udhëzimeve: Okupimi i Himarës nga xhandarmëria shqiptare duhej të bëhej në marrëveshje me krerët e asaj krahine, që kishin fuqi të përfaqësonin popullin e Himarës; Okupimi duhej të bëhej krejt

³⁰ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.45, fl.97. Prefektura e Vlorës-MPB, 14 maj 1921.

³¹ *Po aty*, fl.100. MPB-prefekturave Vlorë e Gjirokastrë, 15 maj 1921.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*, fl.106. MPB-Prefekturës së Gjirokastrës, 18 maj 1921.

³⁴ *Po aty*, fl.112. MPB-Prefekturës së Vlorës, 24 maj 1921.

³⁵ *Po aty*, fl.115. Prefektura Vlorë-MPB, 24 maj 1921.

paqësisht. Oficerët e xhandarmërisë duhej të ishin të krishterë dhe të miratoheshin prej S. Kolekës; Përkohësisht, qeveria shqiptare kërkonte që në Himarë të ngrihej flamuri shqiptar, dogana dhe posta të ishin të lidhura me qeverinë qendrore. Nënprefekti i Himarës do të zgjidhej nga S. Koleka dhe të ishte i pëlqyer nga populli i Himarës. Marrëdhëniet midis qeverisë qendrore dhe Himarës do të caktoheshin në bazë të bisedimeve midis parisë së Himarës dhe qeverisë. S. Koleka ishte i autorizuar që t'i propozonte qeverisë qendrore emërimin e disa oficerëve himarjotë ose të krishterë nga Prefektura e Gjirokastrës³⁶.

Masat e qeverisë ishin rezultative. Në mënyrë paqësore, forcat e xhandarmërisë shqiptare hynë në Himarë më 1 qershor 1921. Ata u pritën me entuziazëm të madh nga popullsia vendase³⁷. Kështu që prej kësaj kohe u vendos autoriteti i shtetit, rendi dhe qetësia.

Akordi i arritur midis përfaqësuesit fuqiplotë të qeverisë shqiptare, Spiro Kolekës, dhe përfaqësuesve të Himarës përmbante këto kushte³⁸: Të njiheshin nga qeveria shqiptare venomet ekonomike që kishte pasur ajo krahinë në kohën turke dhe të paguante një pagesë fikse si dhe më parë; Të njihej liri e plotë në çështjet fetare dhe pasuria e kishave të disponohej prej tyre, siç kishte qenë deri në këtë kohë; Në shkollat e asaj krahine gjuha shqipe të bëhej e domosdoshme (e detyrueshme) dhe zyrtare. Greqishtja do të mësohej si gjuhë e dytë, atje ku populli do të shfaqte dëshirën; Shërbimi ushtarak do të bëhej rregullisht, si dhe në viset e tjera. Përgjithësisht të rinjtë e kësaj krahine do ta bënë shërbimin ushtarak nga Shkumbini e poshtë. Në kohë lufte do të merreshin parasysht rregullat e përgjithshme të shtetit pa asnjë përjashtim; Kryetari i gjykatës të ishte i krishterë por jo himarjot. Gjykata të ishte paqtuese; Himara do të kishte dy deputetë, pavarësisht nga numri i popullsisë; Shpallej amnisti e plotë për të gjitha fajet politike në Himarë.

Gazeta "Mbrojtja Kombëtare" ka dhënë me ngjyra të gjalla ditën e bashkimit të Himarës me Shqipërinë³⁹. Më 6 qershor vullnetarët e Batalionit të Shenjtë, duke kënduar këngë për Luftën e Vlorës, u drejtuan nga Vlora për në

³⁶ *Po aty*, dos.46, fl.35. Letër përfaqësimi e qeverisë shqiptare për delegatin fuqiplotë për zgjidhjen e çështjes së Himarës, 27 maj 1921.

³⁷ Qarkoret e MPB të vitit 1920, f.17. Qarkore e MPB-prefekturave, 4 qershor 1921.

³⁸ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.45, fl.124. Akordi midis përfaqësuesit fuqiplotë të qeverisë shqiptare, Spiro Koleka dhe përfaqësuesve të Himarës, 2 qershor 1921.

³⁹ *Nga Himara*, "Mbrojtja Kombëtare", 27 qershor 1921.

Himarë. Në krye të tyre ishte Spiro Koleka, Qazim Koculi, Rasim Hoxha dhe Aqif Përmeti. Udhëtimi i këtyre të rinjve buzë lumit të Shushicës dhe bjeshkëve të Dogonicës, nën hijen e flamurit shqiptar, kudo shpalli, përhap dhe mbolli farën e bashkimit dhe përparimit kombëtar. Në një miting të mbajtur në Himarë, patrioti himarjot Dhimitër Bala mbajti një fjalim të zjarrtë. Ai tha: "Djema atdhetarë! Misioni juaj i shenjtë u mbarua. Ai do të jetë i paharrueshëm në zemrat e atdhetarëve Breg-Detas. Vendasit e këtij qarku, për herë të parë e shohin këtë pemë dhe dalëngadalë do ta shikojnë, kështu do të kuptojnë gabimet e tyre, të cilat do të zhduken me ndihmën e gjithë bashkatdhetarëve shqiptarë".

Ndërsa në fjalimin e tij, që mbajti në emër të vullnetarëve vlonjatë, Halim Xhelo, tha: "Vëllezër bregdetas të mos u vijë ligisht për gjendjen e sotme të Himarës, sepse ato të meta dhe mungesa që shihen këtu, pothuajse hë për hë janë kudo në të gjithë Shqipërinë, dhe tërë këto janë fryte të padijes së shekujve të shkuar... por ne djalëria do t'i balancojmë të gjitha ndalimet që duan të na pengojnë".

Pas bashkimit të Himarës me atdheun, menjëherë drejtuesit e elementit grekoman të Himarës, me në krye Niko Milon, shkuan në Korfuz⁴⁰. Por edhe disa qarqe patriotike shqiptare ishin të pakënaqura nga akordi i arritur midis qeverisë dhe Himarës. Gazeta "Fjal'e Lirë" theksonte se "himariotët nuk u sollën me zemër e shpirt vëllai, sepse, duke u mbështetur në teorinë e venomeve, që nuk janë vërtetuar kurrë e që i kanë pas trashëguar jo nga ne (shteti shqiptar-BM) deshën të vërtetojnë se ende nuk u është hequr nga mendja shpresa e Ëndrrës së Madhe"⁴¹ (Megali Ideja-B.M.).

Ndërsa gazeta "Posta e Korçës" bënte fajtores qeveritë shqiptare, të cilat "duke mos u larguar dot nga bendellëket dhe akraballeket, kurrë nuk e vranë mendjen se si mund të vinte bashkimi kombëtar i vërtetë... Na duket se gjithë fajti, për sa ngjet, u bashkohet qeverive të deritanishme, të cilat po të ishin kujdesur për një qeverim atnor, nuk do të kishin sjellë kaq pemë të hidhura e dëmprurëse si për politikën e jashtme, ashtu dhe për të brendshmen"⁴².

⁴⁰ AQSh, Fondi: MPB, viti 1921, dos.46, fl.39. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 3 qershor 1921.

⁴¹ Mbi çështjen e Himarës, "Posta e Korçës", 14 qershor 1921.

⁴² Po aty.

Më 15 korrik 1921, Këshilli i Lartë i Shtetit miratoi dekretin e Këshillit të Ministrave të datës 5 korrik për faljen e plotë të të gjitha veprave penale e politike që ishin bërë para hyrjes së ushtrisë kombëtare në Himarë⁴³.

Situata, përgjithësisht, ishte përmirësuar dhe filloi një proces mirëkuptimi. Pikërisht në këto rrethana, Paria e Himarës bëri një deklaratë⁴⁴, në të cilën përgënjeshtroi trillimet e shtypit grek se gjoja qeveria shqiptare kishte shpallur shtetrrëhimin në këtë zonë dhe se po shtrëngonte popullsinë të nënshkruante një protestë kundër copëtimit të atdheut. Në deklaratë thuhej se "ishte fakt i pamohueshëm që populli i krahinës së Himarës, nga pikëpamja kombëtare nuk kishte asnjë ndryshim nga popullsia shqiptare e krahinave të tjera të tokës shqiptare".

Ndërsa shtypi i bëri jehonë një telegrami të popullsisë së Himarës dërguar qeverisë, të cilën e falënderonte dhe e përgëzonte për sigurimin e kufijve të Jugut⁴⁵.

Por autoritetet shqiptare ende ishin të shqetësuar. Togeri Azis Çami informonte se populli i krahinës së Himarës ishte aq shumë i helmuar prej propagandës greke, sa që pret rastin më të vogël për të bërë kryengritje. Ai kërkonte internimin e 50-60 grekomanëve nga më të rrezikshmit, çarmatimin e gjithë popullsisë së asaj krahine dhe dërgimin e menjëhershëm të një force ushtarake në atë krahinë⁴⁶.

Në gusht të vitit 1921 përfaqësuesit e Himarës njoftuan qeverinë se populli i Himarës ishte gati të paguante 20 000 fr. ari në vit, në vend të tatimeve të drejtpërdrejta (xhelepi, e dhjeta, vergjia), me një fjalë për ato tatime që kishin qenë falur më parë nga qeveria turke. Ndërsa ata pranonin të punonin sipas ligjit për ndreqjen e rrugëve⁴⁷.

Prefektura e Vlorës e kundërshtoi këtë kërkesë, duke e konsideruar atë në kundërshtim me Statutin e shtetit shqiptar. Ajo u dha urdhër autoriteteve të Himarës që të shisnin në ankand të dhjetat e shtatë katundeve të Himarës. Edhe Ministria e Brendshme i ftoi banorët e Himarës që t'i bindeshin ligjit si nënshtetas të urtë sepse qeveria nuk mund të pranonte venome që ishin në kundërshtim me Statutin. Mirëpo himarjotët të shtyrë nga agjentura greke,

⁴³ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.357, fl.2. Këshilli i Ministrave-MPB, 5 korrik 1921.

⁴⁴ *Po aty*, dos.45, fl.141.

⁴⁵ *Sigurimi i kufijvet dhe himariotët*, "Posta e Korçës", 25 gusht 1921.

⁴⁶ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.45, fl.132. Togeri Azis Çami-Ministrisë së Luftës, Himarë 1 gusht 1921.

⁴⁷ *Po aty*, dos.46, fl.56.

nxitën gratë e tyre të armatosura me sëpata të vepronin kundër nënprefekturës, ku ishin instaluar disa ushtarë. Ushtarët u përpoqën që t'i shpërndajnë gratë në mënyrë paqësore por nuk mundën. Në këto konfrontime u plagosën tre ushtarë dhe një oficer. Por u vra aksidentalisht edhe një grua dhe u plagosën 11 të tjera. Qeveria menjëherë dërgoi në Himarë një Komision Hetimor, nën kryesinë e prokurorit të gjyqit të Vlorës, Neki Delvina⁴⁸.

Në dhjetor të vitit 1920 prefekti i Janinës, Koço Nano, i kërkoi prefektit të Gjirokastrës, Kol Tromara, që forcat shqiptare të mos hynin në Himarë dhe të respektohej "marrëveshja" e bërë midis dy qeverive që në Himarë të ruhej statuskuoja gjersa të merrej një vendim nga Konferenca e Paqes. Tromara e mohoi ekzistencën e një marrëveshje të tillë dhe theksoi se çështja e Himarës ishte një çështje e brendshme e Shqipërisë⁴⁹.

Pas bashkimit të Himarës me atdheun, agjencia greke dhe njerëzit e saj nuk i hodhën armët.

Problemi i rëndësishëm që doli në këtë kohë ishte çështja e futjes së gjuhës greke në shkolla. Në vitin 1921 qeveria greke protestoi kundër Shqipërisë në LK se ajo kishte ndërprerë mësimin e greqishtes në shkollat fillore dhe kishte lejuar mësimin e gjuhës greke vetëm një orë në ditë në klasat e katërta dhe në klasat më të larta, kishte reduktuar numrin e mësuesve grekë të shkollave fillore në këto fshatra dhe kishte emëruar mësues për të dhënë gjuhën shqipe, "një gjuhë që futej për herë të parë në shkollat greke të Himarës". Qeveria greke shprehte shqetësimin se, me këto masa, qeveria shqiptare po synonte "të shqiptarizonte" popullsinë "greke" të Himarës, duke dhunuar një sistem të privilegjeve që ishte krijuar prej një periudhe të gjatë në të gjithë Epirin e Veriut, dhe kështu, ajo kishte dhunuar Art.3 të Deklaratës së 2 tetorit, të nënshkruar nga delegati shqiptar, F. Noli⁵⁰. Në vitin 1922 Pleqësia e katundeve të Himarës protestoi kundër pakësimit të orëve të gjuhës greke, nga tre orë në javë që kishte në vitin 1921 në një orë në javë⁵¹. Prefektura e Vlorës pohonte se ankuesit ishin intrigantë dhe kërkonte që kërkesa e tyre të mos merrej parasysh, por të zbatohet programi aktual i shkollave, i cili përcaktonte

⁴⁸ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, viti 1921, dos.87.

⁴⁹ *AQSH*, Fondi: MPB, viti 1920, dos.90, fl.6-7. Raport i prefektit të Gjirokastrës, Kol Tromara, mbi bisedën e zhvilluar me prefektin e Janinës, Koço Nano, më 15 dhjetor 1920. Gjirokastër 17 dhjetor 1920.

⁵⁰ *AMPJ*, viti 1921, dos.87, fl.6. Dendramis për Sekretarin e LK, 15 dhjetor 1921.

⁵¹ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1922, dos.730, fl.61. Telegram i Pleqësisë së katundeve të Himarës-MPB, 6 dhjetor 1922.

që në katundet shqiptare të mësohej vetëm gjuha shqipe, ndërsa në katundet shqipfolëse e greqishtfolëse (bilinguale) të mësohej përveç shqipes edhe greqishtja një orë në ditë në rendin e dytë e lart⁵².

Himara kishte tre katunde që flisnin shqip dhe greqisht dhe katër katunde që flisnin vetëm shqip. Një pjesë e parisë së kësaj krahine kërkonin që të mësohej në klasat III-VI gjuha greke nga tre orë në ditë dhe në klasat I dhe II nga dy orë në ditë. Ministria e Arsimit e pranonte këtë kërkesë, por vetëm për tre katundet grekofone d.m.th. Dhërmi, Himarë e Palasë. Në shkollat e katundeve të tjera gjuha greke do të mësohej vetëm në klasat IV, V, VI nga dy orë në ditë, duke i lënë liri mësuesit së cilën lëndë do të jepte në këtë gjuhë⁵³. Por disa mësues po përpiqeshin të sabotonin mësimin e gjuhës shqipe në Himarë. Mësuesi i fshatit Palasë, Spiro Iljadhi nuk kishte filluar dhënien e gjuhës shqipe dhe po bënte propagandë kundër saj. Simo Kosta, mësues i greqishtes në Himarë, ishte një grekoman i vendosur dhe bënte propagandë me nxënësit e klasave të katërta dhe të pesta që të mos pranonin mësimin e gjuhës shqipe⁵⁴.

Edhe Ministria e Brendshme informonte se programi arsimor i Ministrisë së Arsimit nuk po zbatohet në shkollat e Himarës, gjë që po bënte një përshtypje jo të mirë në opinionin publik të atij rrethi⁵⁵.

E gjendur nën presionin grek, Ministria e Jashtme ishte e shqetësuar për gjendjen e shkollave në Himarë. Ajo kishte marrë një telegram proteste nga disa banorë të Himarës, të cilët protestonin kundër nënprefektit të atjeshëm se kishte ndaluar mësimin e gjuhës greke, dhe se i kishte kërcënuar që, po të mos vijonte frekuentimi i rregullt i shkollave nga nxënësit, prindërit e tyre do të konsideroheshin si antikombëtarë dhe fajtorë politikë. MPJ porosiste që, në këto kohë tepër delikate, ishte e domosdoshme të mos shkaktoheshin ankesa të tilla, dhe të jepeshin urdhra kategorike që të lihej i lirë mësimi i gjuhës greke në shkollat e "minoriteteve grekofone"⁵⁶.

Jo të gjitha degët e administratës kishin një mendim për qëndrimin që duhej mbajtur ndaj Himarës. Prefektura e Vlorës e konsideronte si të

⁵² *Po aty*, fl.62. Prefektura e Vlorës-MPB.

⁵³ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1922, dos.107, fl.12. MA-Prefekturës Vlorë, 6 shkurt 1922.

⁵⁴ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1922, dos.730, fl.14. MA-MPB, 28 shkurt 1922.

⁵⁵ *Po aty*, dos.448, fl.1. MPB-MA, 12 nëntor 1922.

⁵⁶ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1923, dos.57, fl.59. MPJ-MA, 13 dhjetor 1922.

favorshme kohën për anulimin e plotë të venomeve⁵⁷. Edhe komanda e xhandarmërisë së Himarës arrestoi disa persona që kishin kundërshtuar urdhëresën e qeverisë për regjistrimin e pasurisë së kishave dhe manastireve. Ata e kishin justifikuar kundërshtimin e tyre me argumentin se regjistrimi cenonte marrëveshjen midis qeverisë dhe himarjotëve për venomet⁵⁸.

Prefektura e Vlorës i kërkoi Ministrisë së Brendshme akordimin e një shume prej 1 000 fr. ari për të zhvilluar propagandë kundër venomeve. Por ajo u përgjigj negativisht, për arsye se buxheti i saj nuk e lejonte akordimin e kësaj shume⁵⁹.

Në shkurt të vitit 1922 u nis për në Tiranë një komision nga Himara i përbërë nga Jani Milo dhe Kostaq Goreci, i cili do t'i kërkonte qeverisë që të mos prisheshin venomet. Por nënprefektura e Himarës informonte se, nëse do të hiqeshin venomet, popullsia e Himarës nuk do të bënte asnjë kundërshtim. I vetmi person që interesoj për ruajtjen e venomeve ishte Jani Milo⁶⁰. Edhe Prefektura e Vlorës e quante të favorshme kohën për të anuluar venomet. Ajo theksonte se, me emërimin e një rrethkomandanti dhe gjykatësi mysliman, venomet e Himarës quheshin të rëna⁶¹. Prefektura e Gjirokastrës këshillonte që heqja e venomeve të bëhej në mënyrë graduale dhe të mos shkaktonte ndonjë anomali në krahinë. Prefekti Kol Tromara nuk e konsideronte të pëlqyeshme heqjen e tyre në këtë moment, kur po afroreshin zgjedhjet⁶². Ministria e Brendshme pranoi propozimin e prefekturës së Vlorës për prishjen e venomeve të Himarës, por këshilloi të bëhej kujdes "që prej këtij shkak, të mos futeshin në veprim të huajt për të luajtur ndonjë rol kundër interesave të shtetit, duke i bërë vegla himarjotët"⁶³. Më 19 prill prefekti i Vlorës, Zenel Prodani, pasi bëri një diskutim të gjatë me parinë e Himarës mbi gjendjen e përgjithshme të shtetit shqiptar e duke e vënë theksin në zgjerimin e Statutit të Lushnjës,

⁵⁷ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1922, dos.448, fl.6. Zëvendësprefekti i Vlorës Neki Ruli-MPB, 5 tetor 1922.

⁵⁸ *Po aty*, fl.1. Zyra e Policisë Himarë-Drejtorisë së Policisë Vlorë, 19 korrik 1922.

⁵⁹ *Po aty*, viti 1923, dos.152, fl.121. Prefektura Vlorë-MPB, 25 janar 1923; fl.122, MPB-Prefekturës Vlorë, 30 janar 1923.

⁶⁰ *Po aty*, fl.1. Prefekti i Vlorës Z. Prodani-MPB, 22 shkurt 1923.

⁶¹ *Po aty*, fl.4. Prefektura Vlorë-MPB, 24 mars 1923.

⁶² *Po aty*, fl.5. Prefekti i Gjirokastrës, Kol Tromara-MPB, 28 mars 1923.

⁶³ *Po aty*, fl.6, 12. MPB-Prefekturës Vlorë, 2 dhe 21 prill 1923.

deklaroi heqjen e venomeve dhe fillimin e punës për emërimin e nëpunësve dhe regjistrimin e ndërtesave⁶⁴.

Sapo komisioni filloi regjistrimin e ndërtesave, popullsia e Himarës, e shtyrë nga agjentët grekomanë, shprehu pakënaqësinë e saj. Për këtë arsye anëtarët e komisionit dhanë dorëheqjen. Për të mos u bllokuar regjistrimi, prefektura formoi një komision provizor prej nëpunësve i cili filloi punën. Prefekti ankohej për nënprefektin e Himarës, i cili nuk po e kuptonte siç duhej rëndësinë e detyrës së tij. Prefekti kërkonte që të qëndronte përkohësisht në këtë krahinë kapiten Aziz Çami, i cili njihej si dorë e fortë e qeverisë. Prefekti Prodani i kërkoi Ministrisë së Brendshme që t'u jepte përgjigje negative kërkesave të himarjotëve për ruajtjen e venomeve, pasi heqja e tyre do të shkatërronte çerdhen më të fortë të propagandës helenike⁶⁵. Ndërsa kapiteni Aziz Çami e quante sjelljen e bregdetasve në këtë mënyrë një bluf me qëllim që të trembnin qeverinë⁶⁶.

Një pjesë e shtypit i bëri jehonë prishjes së venomeve. Ai nënvizoi se populli e priti me entuziazëm këtë akt. Ruajtja e venomeve konsiderohej e dëmshme për vetë Himarën, dhe shprehej bindja se po të mos kishte qenë propaganda e huaj, vetë himarjotët do t'i kishin hedhur poshtë venomet qysh më parë. Shteti shqiptar, në buzë të Adriatikut e brenda në Evropë, nuk mund të mbante më vende të privileguara. Turqia ishte vendi i venomeve, i kapitulacioneve dhe i privilegjeve, ndërsa Shqipëria independente s'mund të pranonte kurrë të cenohej independenca e saj. "Malet e Vetëtimës kishin fituar nga Turqia venome si të huaj që ishin. Por në Shqipërinë e tyre ato s'kishte pse të mbanin më privilegje. Himara me venome e quante veten raja, fjalë e cila nuk e nderon atë"⁶⁷.

Por disa ditë më vonë, prefekti i Vlorës jepte një tablo më realiste të ngjarjeve dhe situatës në Himarë⁶⁸. Ai vinte në dukje se, para se të shkonte në Himarë, çështja e venomeve nuk dukej shumë e rëndësishme. Por pasi vajti atje kishte parë nga afër se himarjotët i konsideronin venomet si tradita të vendit në interes të tij dhe si të shenjta. Prefekti u shpjegoi himarjotëve se qeveria ishte e

⁶⁴ *Po aty*, fl.19. Prefekti i Vlorës, Z. Prodani-MPB, Himarë, 20 prill 1923.

⁶⁵ *Po aty*, fl.16. Prefekti i Vlorës, Zejnel Prodani-MPB, Himarë, 21 prill 1923.

⁶⁶ *Po aty*, fl.23. Kapiten Aziz Çami-Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 21 prill 1923.

⁶⁷ *Venomet e Himarës*, në: "Drita", Gjirokastër, 24 prill 1923.

⁶⁸ *AQSH*, Fondi: MPB, Viti, 1923, fl.115-119. Prefektura e Vlorës-MPB, 26 prill 1923.

shtrënguar të zbatonte gjithkund statutin e miratuar nga parlamenti dhe nuk kishte se si të vazhdonte situata e deriatëhershme e veçantë e Himarës. Ai deklaroi rrëzimin e venomeve. Kjo deklaratë shkaktoi një përshtypje jo të mirë në popull, por më tepër tek paria dhe intrigantët që ishin të lidhur ngushtë me venomet, duke siguruar për vete përfitime morale e materiale të panumërta. Për arsye se vergjia e përvitshme e Himarës nuk ishte ndarë në bazë të barabartë, në proporcion me pasurinë e secilit, por përkundrazi paguante njësoj si i pasuri dhe i varfëri dhe meqë vergjia i merrej popullit por i dorëzohej shtetit nga paria, kjo e fundit dilte gjithmonë e fituar dhe ruante pozita sunduese.

Por kjo s'do të thoshte se pjesa tjetër e popullsisë e priti me kënaqësi prishjen e venomeve, vetëm se kjo nuk u shqetësua aq sa paria dhe elementët grekomanë. Zhurma dhe alarmi i parisë së Himarës ishte artificial dhe i bazuar në interesa personale, të përziera me interesa antikombëtare. Prefekti i Vlorës nënvizonte se, vetëm duke prishur venomet, Himara shqiptare do të rifitonte karakterin dhe ndjesinë kombëtare, që i kishte humbur në rrjedhën e shekujve, duke u helmuar me propaganda të huaja. Veç kësaj, vazhdimi i venomeve të Himarës do të përbënte rrezik për shtetin shqiptar e për njësinë kombëtare, sepse, herët a vonë, mund të merrej si shembull prej ndonjë krahine tjetër të Shqipërisë. Ai informonte se prishja e venomeve kishte bërë një përshtypje të madhe në favor të qeverisë në zonat kufitare me Himarën, si në Kurvelesh, Gjirokastër e Vlorë.

Por Ministria e Jashtme ndërhyri sërish duke këshilluar që ndaj Himarës të veprohej me kujdesin më të madh. Ajo e cilësonte situatën shumë delikate, në një kohë kur për administratën e Shqipërisë Jugore ishin bërë ankesa në Lidhjen e Kombeve dhe Këshilli i LK, që ishte mbledhur në Gjenevë, kishte falënderuar profesor Sederholmin për hetimet e thella që kishte bërë në Shqipëri. MPJ këshillonte që të veprohej me butësi dhe kujdes në këtë periudhë delikate, pasi kështu kërkonin interesat kombëtare, dhe se nuk duhej dërrmuar menjëherë një situatë e tillë që kishte vazhduar prej shekujsh. Në këtë periudhë të parë të jetës politike të shtetit shqiptar, ndaj elementit të krishterë të ndiqej një politikë e butë dhe jo e ashpër. Ajo informonte MPB se marrëveshja që ishte bërë midis parisë së Himarës dhe përfaqësuesit të qeverisë shqiptare i ishte njoftuar Lidhjes së Kombeve. Për këto arsye, Ministria e Jashtme kërkonte që statuskuoja në Himarë të ruhej⁶⁹.

Në të njëjtën kohë Mit'hat Frashëri kishte informuar Ministrinë e Jashtme se një zyrtar i MPJ të Greqisë kishte protestuar për çështjen e Himarës. Mit'hati

⁶⁹ AMPJ, viti 1923, dos.209, fl.5. MPJ-MPB, 30 prill 1923.

i ishte përgjigjur se në kohën e sundimit turk venome kishte çdo mal, dhe tani qeveria shqiptare s'mund t'i njihte këto venome. Ai i kishte bërë një pyetje kundërshtuese diplomatit grek: "Ku do të përfundonte Greqia sikur Moreja ose viset e tjera të Peloponezitet të pretendonin për venome?"⁷⁰.

Ndërkohë Prefektura e Vlorës po vijonte përpjekjet për regjistrimin e ndërtesave në Himarë. Ajo kërkonte që regjistrimi të vazhdonte dhe himarjotët të kuptonin se ishin para një muri që s'mund t'i binin me kokë. Ajo informonte se flamurin e kundërshtimit kundër prishjes së venomeve e kishte marrë familja Milo, me disa intrigantë, që ishin të njohur për tradhti ndaj atdheut. Prefektura e Vlorës mendonte të vinte përpara përgjegjësisë Jani Milon dhe familjen e tij. Megjithatë ajo informonte se të gjitha përpjekjet e saj për prishjen e venomeve ishin bërë në mënyrë paqësore dhe me urtësi⁷¹.

Alarmi ndaj reagimit grek vijonte të ishte i lartë në MPJ. Dukej se kishte një ndryshim të fortë pikëpamjesh midis MPJ dhe prefekturës së Vlorës. Ministria e Jashtme njoftoi Kryeministrinë se qeveria greke kishte protestuar kundër përpjekjeve të autoriteteve shqiptare për heqjen e venomeve në Himarë. Ajo i kishte komunikuar se këto përpjekje kishin shkaktuar një zemërim të madh në Greqi, ku ishin mbajtur mitingje. Kopjet e të gjitha këtyre protestave u ishin shpërndarë përfaqësive të huaja në Athinë. Qeveria greke kërkonte që venomet e Himarës të respektoheshin dhe paralajmëronte që, në rast të kundërt, do të kishte pasoja negative në marrëdhëniet midis dy vendeve. Ministria e Jashtme e Shqipërisë e konsideronte këtë notë si fillimin e ndërhyrjes së Greqisë në punët e brendshme të Shqipërisë⁷². Ndërsa Legata Greke në Durrës kishte bërë një protestë me gjuhë të ashpër në kundërshtim me normat e mirësjelljes diplomatike për çështjen e Himarës⁷³. Një ditë më vonë MPJ e Shqipërisë i dha një përgjigje të shkurtër Legatës Greke, në të cilën shprehej dëshira e sinqertë për marrëdhënie miqësore midis dy shteteve, por nënvizoi se qeveria shqiptare nuk mund të pranonte në asnjë mënyrë ndërhyrjen e të huajve në punët e brendshme të shtetit shqiptar⁷⁴. Nga ana e saj, edhe Prefektura e Vlorës vijonte të ushtronte presion në MPB që të vijonte me vendosmëri procesin e eliminimit të venomeve. Ajo pohonte se alarmi për heqjen e venomeve ishte i kufizuar vetëm në një grup shumë të ngushtë intrigantësh, kurse populli i Himarës ishte fare i qetë. Kështu ajo "pranonte

⁷⁰ *Po aty*, Mit'hat Frashëri-MPJ, 30 prill 1923.

⁷¹ *Po aty*, fl.8-9. Prefektura Vlorë-MPB, 2 maj 1923.

⁷² *Po aty*, fl.10. MPJ-Kryeministrisë, 2 maj 1923.

⁷³ *Po aty*, fl.15. MPJ-Mit'hat Frashërit, 7 maj 1923.

⁷⁴ *Po aty*, dos.152, fl.112. MPJ-MPB, 8 maj 1923.

përgjegjësitë më të rënda në qoftë se në Himarë do të ndodhte ndonjë lëvizje e vogël në mënyrë revolucionari". Prefektura kërkonte zëvendësimin e nënprefektit të Himarës, që ishte bërë pengesë për heqjen e venomeve; që të mos përkëdhelej Jani Milo, me shokë, që po shkonte në Tiranë për t'u ankuar, por t'i jepej atij një përgjigje e prerë; të vijohej e të përfundohej procesi i regjistrimit të ndërtesave dhe bagëtive, i cili po i afrohej fundit dhe të mos anulohesh urdhri për nxjerrjen e tatimeve pasi kjo do të merrej si një dobësi e qeverisë⁷⁵. Prefekti Zenel Prodani informonte se në procesin e prishjes së venomeve nuk ishte prekur aspak liria personale e popullsisë së Himarës dhe nuk ishin shkelur ligjet, ndërsa ankimet e disa himarjotëve për burgosjen e priftërinjve atje ishin krejtësisht të rreme.

Edhe Prefektura e Gjirokastrës konfirmonte se në Himarë nuk dukeshin shenjat e ndonjë lëvizje, porse një komision kishte vajtur në Korfuz për t'u ankuar tek Fuqitë e Mëdha lidhur me heqjen e venomeve⁷⁶.

Më së fundi edhe Ministria e Brendshme doli në mbrojtje të veprimeve që ishin ndërmarrë nga autoritetet lokale në Himarë. Ajo konfirmonte se procesi i regjistrimit të banesave dhe bagëtive ishte zhvilluar i qetë dhe në atë krahinë mbretëronte qetësia e plotë⁷⁷.

Në këtë situatë, filloi të reagoonte edhe pjesa e popullsisë së Himarës, e cila mbështeste masat dhe politikën e qeverisë shqiptare. Milo Varfi nga Vunoi, në emër të Djalërisë Kombëtare Bregdetase, i kërkoi Ministrisë së Brendshme që të mos merrte parasysh asnjë kërkesë të Komisionit të kryesuar nga Jani Milo, i cili përfaqësonte vetëm mentalitetin e ndryshkur të ushqyer me edukatë të huaj, sepse ndryshe, qeveria, me dëshirën e saj, do të shtypte moralin dhe hovin e djalërisë bregdetase⁷⁸.

Prefektura e Vlorës vijonte presionet ndaj MPB që të mos ndalohej vjelja e taksave në Himarë, pasi kjo do të merrej si një dobësi e qeverisë dhe do të bënte përshtypje të keqe në qarkun e Vlorës dhe Kurveleshit. MPB konfirmonte se qeveria nuk i njihte venomet, por taksat nuk do të mblidheshin

⁷⁵ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1923, dos.152, fl.49. Prefektura Vlorë-MPB, 3 maj 1923.

⁷⁶ *Po aty*, fl.53. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 5 maj 1923.

⁷⁷ *Po aty*, fl.37-40. MPB-MPJ, 3 maj 1923.

⁷⁸ *Po aty*, Fondi: Kryeministria, viti 1923, dos.I-1909, fl.1. Letër e Milo Varfit në emër të Djalërisë Kombëtare Bregdetase-MPB, 9 maj 1923.

në Himarë, në mënyrë që simpatia e himarjotëve për qeverinë aktuale të vijonte të paktën derisa të merrte fund çështja e caktimit të kufirit⁷⁹.

Edhe grupi himarjot venomist u përpoq të kundërvepronte. Sapo u kthye nga Tirana, Komisioni filloi të propagandojë se si rezultat i presionit të tij u vendos ruajtja e venomeve dhe se në rast të kundërt, qeveria greke do të kishte prerë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Komisioni gjithashtu shpërndau njerëzit e tij në katunde për të firmosur një dokument, i cili kërkonte bashkimin e Himarës me prefekturën e Gjirokastrës⁸⁰. Kjo propagandë dhe transferimi i oficerëve të xhandarmërisë Halim Çelo dhe Xhevdet Çelo nga Himara shkaktuan hutim tek një pjesë e popullsisë që mbështeste qeverinë në zonat e tjera të Vlorës e Kurveleshit, të cilat dyshohej se mund të organizonin demonstrime kundër qeverisë. Për këtë arsye komanda e xhandarmërisë së Vlorës kërkoi që qeveria të shpallte qartë se i kishte hequr venomet Himarës⁸¹. Edhe bashkitë e Tepelenës dhe Kurveleshit u përfshinë në këtë çështje, duke i kërkuar qeverisë që të mos pranonte kërkesën e himarjotëve për venome. Zëvendëskryetari i Bashkisë së Kuçit, Ali Riza shkruante: "Populli i Kuçit u gëzua shumë për ngritjen(heqjen) e venomeve të Himarës më 19 prill dhe lutet që në emër të interesit të përgjithshëm kombëtar të mos u jepen venome himarjotëve. Ne, megjithëse jemi shumë më të varfër se himarjotët, nuk i kërkojmë dhe nuk i pranojmë kurrë venomet"⁸².

Prefektura e Vlorës informonte se popullsia e krahinave që kufizoheshin me Himarën po kërkonte prej qeverisë të vijonte veprimet e filluara, sepse në rast të kundërt edhe ajo do të kërkonte akordimin e venomeve⁸³. Këtë situatë e konfirmonte edhe inspektori i Ministrisë së Brendshme, Neki Ruli, i cili shtonte se ngritja e venomeve të Himarës kishte kënaqur gjithë qarkun e prefekturës së Gjirokastrës e të Vlorës, por lajmi që kishte përhapur Komisioni i Himarës kishte dëshpëruar të gjithë viset e lartpërmendura, të cilat përgatiteshin të protestonin kundër qeverisë. Partia qeveritare po humbiste gjithë simpatinë e saj, dhe qeveria duke mbajtur pezull çështjen e venomeve, po humbiste nga të

⁷⁹ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1923, dos.152, fl.64. MPB-prefekturës Vlorë, 10 maj 1923.

⁸⁰ *Po aty*, fl.80. Prefektura e Vlorës-MPB, 16 maj 1923.

⁸¹ *Po aty*, fl.84. Komandanti i qarkut Vlorës, Azis Çami-Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Vlorë 20 maj 1923.

⁸² *Po aty*, dos.225, fl.4, 7-8. Zëvendëskryetari i Bashkisë së Kuçit Ali Riza-MPB, 12 maj 1923, Zëvendëskryetari i Bashkisë së Tepelenës, N. Rexhepi-MPB, 26 maj 1923.

⁸³ *Po aty*, dos.152, fl.90. Prefektura Vlorë-MPB, 22 maj 1923.

gjitha anët. Edhe administrata lokale nuk e kishte përcaktuar rrugën se si do të vepronte në Himarë. Gjendjen ai e cilësonte kritike prandaj kërkonte përgënjeshtimin e lajmit të përhapur prej Komisionit himarjot dhe të fillonte mbledhjen e taksave, si në çdo krahinë të Shqipërisë⁸⁴.

Kreu i propagandës greke që po zhvillohej hapur në Himarë, ishte Spiro Milo, i cili ndodhej në Greqi si nëpunës i shtetit grek. Ai e zhvillonte propagandën në të shtatë katundet e Himarës, nëpërmjet 5-6 personave që konsideroheshin si paria e Krahinës. Këta ishin: i vëllai i Spiro Milos, Jani Milo, Thanas Bollano, Miço Kara, Andrea Ilia, avokati Petro Kiço, prifti Papa Spiro e Jorgo Simo. Ky i fundit ishte përpjekur edhe të sabotonte shitjen e së dhjetës në ankand, duke u mbështetur tek venomet⁸⁵.

Në shtator të vitit 1923 filluan përsëri përpjekjet e një pjese të banorëve të katundeve bilinguale për të emëruar në shkollat e tyre mësues të gjuhës greke, duke pranuar që të paguanin vetë rrogat e tyre. Ata e mbështesnin këtë kërkesë në pretendimin se kishin statusin e minoritetit. Kjo kërkesë, me sa duket, ishte nxitur nga një paragraf i raportit të këshilltarit Hunger, i cili pohonte se Këshilli i Ministrave, në maj të atij viti u kishte dhënë leje banorëve që flisnin gjuhën greke që të hapnin shkolla me shpenzimet e tyre ose të shtonin mësues nëpër shkollat ekzistuese. Por nënprefekti i Himarës pohonte se kishte ndikuar edhe mosbesimi që ekzistonte në Himarë për shkollat kombëtare, përparimi i të cilave kishte qenë shumë i vogël⁸⁶. Ai paralajmëronte se, në qoftë se do të merreshin parasysh këto kërkesa, ato do të përsëriteshin edhe nga katundet e tjera jo vetëm ato që flisnin dy gjuhët, por edhe fshatrat shqipfolëse, gjë që do të greqizonte krejt shkollat e këtij qarku⁸⁷.

Për të fituar kohë, Prefektura e Vlorës u përgjigj se çështja do të shqyrtohej nga Ministria e Arsimit dhe përgjigja do të komunikohet më vonë⁸⁸. Në fund të shtatorit, venomistët filluan përpjekjet për sabotimin e mësimit në shkollat shtetërore të Himarës, si mjet presioni për caktimin e mësuesve të

⁸⁴ *Po aty*, fl.97. Inspektori i MPB, Neki Ruli-Zyrës Sekrete të MPB, 24 maj 1923.

⁸⁵ *Po aty*, dos.188, fl.16. Zyra e Policisë Himarë-Komisarisë së Policisë Vlorë, 25 shtator 1923.

⁸⁶ *Po aty*, fl.7, 8. Nënprefekti i Himarës J. Eski-Prefekturës së Vlorës, 6 dhe 14 shtator 1923.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ *Po aty*, fl.5. Prefektura Vlorë-MPB, 19 shtator 1923.

gjuhës greke që ata kishin kërkuar⁸⁹. Gjendja u bë shqetësuese dhe Ministria e Arsimit informoi Kryeministrinë se katundet e Himarës kurrsesi nuk mund të përfitonin nga të drejtat e minoriteteve, sepse asnjëri prej tyre nuk ishte grekofon në gjuhën familjare. Gjuha greke këtu kishte qenë si mjet kulture e propagande e përhapur me anë të shkollave greke. Megjithëkëtë, kur filloi çelja e shkollave shtetërore në këtë qark, në bazë të marrëveshjes që u bë me përfaqësuesit e kësaj krahine, në shkollat fillore u vendos edhe mësimi i gjuhës greke një orë në ditë. Kështu që këto fshatra nuk mund të kërkonin caktimin e mësuesve të veçantë për gjuhën greke. Ministria e Arsimit kërkonte largimin e nënprefektit të Himarës, i cili kishte toleruar sabotimin e shkollave shtetërore dhe mjekun e Himarës që ishte pjesë e këtij plani dhe të detyrohej popullsia, sipas ligjit në fuqi, të dërgonin fëmijët në shkollë⁹⁰. Edhe mësuesi i shkollës së Himarës, Tahir Hoxhaj, informonte se shkaktarët dhe nxitësit kryesorë të këtij sabotimi ishin 5-6 persona nga pleqësia e Himarës si dhe nënprefekti i atjeshëm, të cilin e akuzonte si krahun e djathtë të atyre që po bënë propagandë antikombëtare. Interesant është fakti se ai i cilësonte kërkesat për shkolla e mësues grekë në Himarë si pasojë e mbajtjes së shkollave grekofone në zonën e Dropullit e Delvinës dhe kërkonte edhe mbylljen e këtyre shkollave,⁹¹ kërkesë e cila ishte jo realiste dhe me karakter nacionalist.

Sabotimi i mësimëve vijoi edhe në muajt nëntor-dhjetor 1923. Për këtë arsye nënprefekti i Himarës, Stamati, i kërkoi MPB rivendosjen e zbatimit të ligjit për fajet politike të vitit 1920, i cili përcaktonte dënime të rënda të propagandistëve kundër gjuhës amtare, ose, nëse kjo s'do të ishte e mundur, të bëhej një ligj tjetër me dënime të rënda⁹². Pleqësia e Himarës i kërkoi Kryeministrisë që bashkë me gjuhën shqipe të mësohej dhe gjuha greke, 3 orë në ditë në klasat e larta dhe 2 orë në ditë në klasat e ulëta, sipas programit të Ministrisë së Arsimit⁹³. Ndërkohë grupi iniciator për shtimin e orëve të gjuhës greke në shkolla, në bashkëpunim me qarqet greke në Korfuz, i dërguan një

⁸⁹ *Po aty*, fl.16. Zyra e Policisë Himarë- Komisarisë së Policisë-Vlorë, 25 shtator 1923.

⁹⁰ *Po aty*, fl.13. MA-Kryeministrisë, 23 tetor 1923.

⁹¹ *Po aty*, fl.28. Mësuesi i shkollës së Himarës, Tahir Hoxhaj-MA, 1 nëntor 1923.

⁹² *Po aty*, dos.406, fl.3. Nënprefekti i Himarës, Stamati-MPB, 13 dhjetor 1923.

⁹³ *Po aty*, Fondi: Kryeministria, viti 1923, dos.IV-75, fl.6. Jani Spiro Milo-Kryeministrisë, 15 dhjetor 1923.

telegram Lidhjes së Kombeve për t'u siguruar të drejtat e tyre⁹⁴. Ministria e Brendshme i kërkoi Kryeministrisë që ligjet e shtetit të aplikoheshin kudo njëjloj dhe kërkesat e parisë së Himarës nuk duhej të merreshin parasysht. Ajo kërkoi marrjen e masave ndëshkimore⁹⁵.

Vetëm në janar të vitit 1924 u arrit një marrëveshje midis dy palëve për mësimin e greqishtes nga një orë në ditë. Ndryshimi ishte se tani mësimi i kësaj gjuhe do të fillonte qysh në rendin e parë dhe jo në të tretin siç kishte qenë më parë. Pas kësaj marrëveshje do t'i jepej fund bojkotit dhe nxënësit do të vijonin rregullisht shkollën⁹⁶.

Ndërkohë vijonin informacionet për propagandën që po bënte Niko Milo (vëllai tjetër i Spiro Milos) se Himara do të pushtohej nga forcat greke⁹⁷.

Pleqësia e Himarës nuk e zbatoi marrëveshjen e lartpërmendur dhe vijoi përsëri bojkotimin e shkollave. Në fund të janarit 1924, nga 200 nxënës që kishte qendra e Himarës vijonin mësimet vetëm 33 nxënës⁹⁸. Ministria e Arsimit informoi MPJ se paria grekomane po kërkonte që shkollat të ishin krejtësisht greke dhe po vijonte të mbante qëndrimin obstruksionist⁹⁹.

Si përfundim mund të thuhet se gjatë kësaj periudhe shteti shqiptar bëri përpjekje serioze për stabilizimin dhe përfundimin e identitetit kombëtar shqiptar të Himarës. Në këtë betejë ai u ndesh në mënyrë të hapur dhe të tërthortë me influencën dhe politikën greke, si dhe me trashëgiminë e së kaluarës osmane në këtë krahinë. Me gjithë destabilitetin politik të kësaj periudhe, shteti shqiptar arriti disa rezultate, por procesi i bashkimit shpirtëror të gjithë popullsisë së Himarës me kombin dhe shtetin shqiptar mbeti i papërfunduar.

⁹⁴ *Po aty*, dos.I-1909, fl.6. Nënprefekti i Himarës, Stamati-MPB, 16 dhjetor 1923.

⁹⁵ *Po aty*, fl.7. MPB-Kryeministrisë, 17 dhjetor 1923.

⁹⁶ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1923, dos.406, fl.17-19. Prefektura Vlorë-MPB, 15 janar 1924.

⁹⁷ *Po aty*, dos.97, fl.14. Raport i Inspektorit të MPB, Neki Ruli, 31 dhjetor 1923.

⁹⁸ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1923, dos.57, fl.76. Drejtorja e Shkollës Himarë-MA, 29 janar 1924.

⁹⁹ *Po aty*, fl.60. MA-MPJ, 16 janar 1924.

*S u m m a r y*THE ALBANIAN-GREEK CONFRONTATION ABOUT HIMARA
1920-1924

Himara is an Albanian region with clear traits of national Albanian affiliation. After the end of the WWI the Albanian patriotic movement in Himara was revived. However in the same period it continued also a flagrant movement that was led by Spiro Milo and Niko Milo whom in 1914 and 1920 declared the autonomy of Himara and 7 villages. This caused the reaction of the Albanian population with high patriotic feelings in these villages but also in adjunct regions by arousing deep irritation and tension. The Albanian government intervened to stop any attack of the population around against Himara and took measures to resolve the issue peacefully. The Albanian government was under strong pressure from Greece which was asking for the recognition and respecting of the autonomy of Himara. The participation of the Himariots in the elections of 1921 it was very low. On the other hand the Greek government it exploited the situation created in Himara in order to increase the pressure and the oppression of the Albanian element in Chamuria where in 1921 it was being conducted the campaign for the collection of the weapons. After difficult negotiations the government concluded a peaceful agreement with the inhabitants of Himara for a peaceful union with the central government in first of July 1921 by accepting to recognize all the earlier economical rights and the Albanian language was going to be official while Greek was going to be taught as a second language wherever people would ask for.

However even later the Greek propaganda continued and its major problem was the entry of Greek language in schools. The philogreek stream requested that the Greek language to be used primarily while the Albanian government tried to remove totally the economical rights by having a unique policy as in the entire country. However the Ministry of the Foreign Affairs by estimating international position of Albania as delicate it objected these efforts and asked that in Himara to be maintained the status quo. In order to achieve the objectives the philogreek stream in Himara organised the boycott of the public schools in Albanian.

In conclusion it can be said that during this period the Albanian state made serious efforts for the stability and enhancement of the national identity in Himara. In this battle the Albanian government it encountered openly or indirectly with the Greek politics and with the heritage of the ottoman past. Beside the political instability of this period the Albanian state made some achievements but the process of spiritual unification of all of the population of Himara with the Albanian nation and state was left unaccomplished.